



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-06/PL001

Vendosi: Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart
Gjykatës Mihail Bolander

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 gusht 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”), duke marrë parasysh nenet 3(2) dhe 48(6) dhe (7) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 58, 59, 82(4), 193 dhe 194 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”)¹ ka marrë në shqyrtim Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit të Apelit në lidhje me Rishqyrtimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit (IA014/F00008)” (“Kërkesa”).²

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, z. Kadri Veseli u arrestua në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,³ në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij.⁴

2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrëzoi kërkesën e z. Veseli për lirim të përkohshëm (“Vendimi i Parë për Paraburgimin”).⁵

3. Më 30 prill 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e z. Veseli kundër

¹ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

² PL001/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit të Apelit në lidhje me Rishqyrtimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit (IA014/F00008), 29 qershor 2022 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik i Kërkesës u dorëzua më 4 korrik 2022. Shih PL001/F00001/RED.

³ F00027/A03, Fletarrestim për Kadri Veselin, 26 tetor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 nëntor 2020 (F00027/A03/RED); F00050, Njoftim i Arrestimit i Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020.

⁴ F00026, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 26 tetor 2020 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020. Shih F00026/RED. Aktakuza në fuqi u dorëzua më 3 shtator 2021. Shih F00455/A01, Versioni i Redaktuar Publik i ‘Aktakuzës’, KSC-BC-2020-06/F00455/A01/RED, i datës 3 shtator 2021, 8 shtator 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 shtator 2021). Versioni konfidencial me më pak redakte i aktakuzës së korrigjuar u dorëzua më 17 janar 2022. Shih F00647/A01, Version Konfidencial me më pak Redakte i ‘Aktakuzës’, KSC-BC-2020-06/F00455/A01, të datës 3 shtator 2021, 17 janar 2022 (konfidencial).

⁵ F00178, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm, 22 janar 2021.

Vendimit të Parë për Paraburgimin ("Vendimi i Parë i Apelit").⁶

4. Më 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rishikoi paraburgimin e z. Veseli dhe urdhëroi vazhdimin e tij ("Vendimi i Dytë për Paraburgimin").⁷

5. Më 15 korrik 2021, z. Veseli dorëzoi apel kundër Vendimit të Dytë për Paraburgimin.⁸

6. Më 1 tetor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht apelin e z. Veseli dhe ia ktheu këtë çështje Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm në përputhje me vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit ("Vendimi i Dytë i Apelit").⁹

7. Më 11 tetor 2021, z. Veseli dorëzoi parashtrime lidhur me rishikimin e rregullt të paraburgimit të tij,¹⁰ dhe në to përfshiu informacionin e marrë nga Policia e Kosovës në lidhje me aftësinë e saj për të zbatuar kushtet e lirimit të përkohshëm.¹¹

8. Më 27 tetor 2021, në vijim të një urdhri të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Policia e Kosovës dha informacion në lidhje me aftësinë e saj për të zbatuar disa kushte të caktuara që kishin të bënin me lirimin e përkohshëm në Kosovë.

9. Më 23 nëntor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi Vendimin e Dytë për Paraburgimin dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli ("Vendimi

⁶ IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021.

⁷ F00380, Vendim në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit, 2 korrik 2021 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë. Shih F00380/RED.

⁸ Apeli i Vendimit të Dytë për Paraburgimin, para. 11-12 (pika iv e apelit).

⁹ IA008/F00004, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë. Shih F00004/RED.

¹⁰ F00518/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit (KSC-BC-2020-06/F00518 i datës 11 tetor 2021) (F00518/COR i datës 14 tetor 2021), 25 nëntor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 nëntor 2021, versioni i korrigjuar konfidencial u dorëzua më 14 tetor 2021).

¹¹ F00518/COR/A01, Shtojca 1 e Versionit të Korrigjuar të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit (KSC-BC-2020-06/F00518 i datës 11 tetor 2021), 14 tetor 2021 (konfidencial) (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 11 tetor 2021).

i Tretë për Paraburgimin").¹²

10. Më 3 dhjetor 2021, z. Veseli apeloj Vendimin e Tretë për Paraburgimin.¹³

11. Më 31 mars 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Vendimin mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit ("Vendimi i Kundërshtuar"), me të cilin rrëzoi apelin e z. Veseli kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli.¹⁴

12. Më 26 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim tjetër në kuadër të rishikimit të rregullt të paraburgimit sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(1) të Rregullores, me të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli ("Vendimi i Katërt për Paraburgimin").¹⁵ Z. Veseli nuk e apeloj këtë vendim.

13. Më 29 qershor 2022, z. Veseli dorëzoi Kërkesën kundër Vendimit të Kundërshtuar.

14. Më 30 qershor 2022, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme.¹⁶

15. Më 18 korrik 2022,¹⁷ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigjen e saj ("Përgjigja")¹⁸. Z. Veseli u kundërpërgjigj më 25 korrik 2022

¹² F00576, Vendim mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 23 nëntor 2021 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik i këtij vendimi u dorëzua më 8 dhjetor 2021. Shih F00576/RED.

¹³ IA14/F00004, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 3 dhjetor 2021 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 janar 2022. Shih IA14/F00004/RED.

¹⁴ IA14/F00008, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit, 31 mars 2022 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik i Vendimit të Kundërshtuar u dorëzua po atë ditë. Shih IA14/F00008/RED.

¹⁵ F00819, Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 26 maj 2022.

¹⁶ PL001/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës Supreme, 30 qershor 2022 (konfidencial). Vendimi u riklasifikua si publik më 6 korrik 2022.

¹⁷ PL001/F00005, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit, 6 korrik 2022, para. 9.

¹⁸ PL001/F00006, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, me Shtojcën Publike 1, 18 korrik 2022 (konfidenciale). Paneli i miratoi Mbrojtjes zgjatjen

(“Kundërpërgjigja”).¹⁹

16. Më 26 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim tjetër në kuadër të rishikimit të rregullt të paraburgimit, më të cilin vazhdoi paraburgimin e z. Veseli (“Vendimi i Pestë për Paraburgimin”).²⁰

II. PRANUESHMËRIA

17. Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë dy kushte të cilat duhet të plotësohen para se Paneli të shqyrtojë themelësinë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Sipas nenit 48(6) të Ligjit, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet t’i parashtrohet Kryetarit të Gjykatës brenda tre muajsh pas dhënies së aktgjykimit ose vendimit të formës së prerë, kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Rrjedhimisht, aktgjykimi ose vendimi duhet të jetë i formës së prerë dhe kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit të përcaktuar në ligj.

18. Një vendim ose aktgjykim është i formës së prerë “kur nuk janë të disponueshme mjete të tjera juridike të zakonshme ose kur palët i kanë shteruar ato mjete, ose e kanë lënë afatin të kalojë pa i shfrytëzuar ato”.²¹ Gjithashtu, rregulla 59 e Rregullores përcakton se “personi i paraburgosur mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë kundrejt vendimeve të formës së prerë kur urdhërohet ose zgjatet mbajtja në paraburgim sipas rregullës 58”. Rregulla 58 e Rregullores trajton apelet e ndërmjetme para Panelit të Gjykatës së Apelit kundër vendimeve “në lidhje me mbajtjen në paraburgim”. Nga kjo rrjedh se vetëm vendimet e formës së prerë për paraburgimin të lëshuara nga Paneli i Gjykatës së Apelit janë objekt i kërkesës për

e afatit për dorëzimin e përgjigjes së saj. Shih PL001/F00005, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit, 6 korrik 2022.

¹⁹ PL001/F00007, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës së Saj për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Vendimit të Apelit mbi Rishikimin e Paraburgimit (IA014/F00008), 25 korrik 2022 (konfidenciale).

²⁰ F00897, Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 26 korrik 2022.

²¹ Shih, p.sh., Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Zolotukhin v. Russia*, No. 14939/03, Judgment, 10 February 2009, para. 107; *Nikitin v. Russia*, No. 50178/99, Judgment, 20 July 2004, para. 37.

mbrojtje të ligjshmërisë.²² Kalimi i afateve pa paraqitur apel në Gjykatën e Apelit nga një palë nuk mund të konsiderohet arsye e vlefshme për pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

19. Vendimi i Kundërshtuar i Panelit të Gjykatës së Apelit që la në fuqi Vendimin e Tretë për Paraburgimin, është vendim i formës së prerë sipas nenit 48(6) të Ligjit dhe rregullave 2, 59 dhe 193(1) të Rregullores, pasi ai nuk mund të apelohej më. Vendimi i Kundërshtuar doli më 31 mars 2022 dhe Kërkesa u dorëzua më 30 qershor 2022, brenda afatit. Rrjedhimisht, Kërkesa është e pranueshme.

III. STANDARDI I SHQYRTIMIT

20. Fillimisht, Paneli thekson se z. Veseli ka kërkuar mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me vendimin për vazhdimin e paraburgimit të tij. Kjo kërkesë ka të bëjë me pretendimet për shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore, sipas nenit 48(7)(b) të Ligjit. Rrjedhimisht, në përcaktimin e standardit të shqyrtimit, Paneli do të përqendrohet vetëm në shkeljet thelbësore të procedurave.

21. “Mbrojtja e ligjshmërisë” si mjet juridik i jashtëzakonshëm i paraparë në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe rregullat 193 dhe 194 të Rregullores, i ka rrënjët në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (“KPP”).²³ Mbrojtja e ligjshmërisë nuk ka për qëllim të krijojë një mundësi tjetër të përgjithshme për të bërë apel. Përkundrazi, ajo kufizohet në rastet e veçanta të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore. Siç ka përcaktuar Gjykata Supreme e Kosovës:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kërkesat e rrepta të pranueshmërisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale.²⁴

²² Shih, në përgjithësi, Gjykata Supreme e Kosovës, PmL-Kzz 106/2017, Aktgjykim, 24 maj 2017, f. 7.

²³ Nenet 418(3), 432-441 të KPP-së; Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L.123, miratuar më 13 dhjetor 2012 dhe që hyri në fuqi më 1 janar 2013.

²⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, PmL-Kzz 42/2017, Aktgjykim, 10 maj 2017, para. 23.

22. Në përcaktimin e standardit të shqyrtimit, Paneli do të udhëhiqet nga dispozitat e përmendura në paragrafin pararendës dhe, sipas rastit, nga KPP-ja, jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe jurisprudenca e gjykatave dhe tribunaleve penale ndërkombëtare, kur është relevante.²⁵

23. Neni 48(7) i Ligjit vendos një standard të lartë për sa i takon shkeljes së procedurave. Shkelja procedurale duhet të jetë “thelbësore”, një fjalë, kjo sinonime të së cilës janë, për shembull fjalët “esenciale”, “e rëndësishme”, “themelore” ose me “domethënie reale”.²⁶ Rrjedhimisht, “shkelja thelbësore” është një shkelje me ndikim juridikisht thelbësor mbi konstatimin gjyqësor.

24. Nëse shkelja e pretenduar është “[...] “shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe [...] Rregullore [...]” duhet të vlerësohet rast pas rasti, sipas rrethanave të secilës kërkesë e veçantë.²⁷ Në lidhje me këtë, Paneli mban parasysh nenin 432(1.2) së bashku me nenin 384 të KPP-së, ku jepen shembuj të ndryshëm të shkeljeve procedurale, që mund të shërbejnë si udhërrëfyes për Panelin në marrjen e vendimit mbi Kërkesën. Paneli i Gjykatës Supreme mund të konstatojë “shkelje procedurale thelbësore”, nëse, për shembull, Paneli i Gjykatës së Apelit, (1) nuk zbatoi një dispozitë të Ligjit ose Rregullores; (2) zbatoi në mënyrë të gabuar Ligjin dhe/ose Rregulloren; ose (3) shkeli të drejtat e Mbrojtjes në një mënyrë që u ndikua dhënia e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.

25. Rrjedhimisht, i takon palës që përdor mjetin juridik për mbrojtjen e ligjshmërisë që të evidentojë dhe provojë shkeljen e pretenduar, dhe të shpjegojë se si ajo pati

²⁵ Paneli është i vetëdijshëm se gjykatat dhe tribunale të penale ndërkombëtare nuk kanë dispozita në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë. Megjithatë, Paneli gjykon se mund të mbështetet në jurisprudencën e tyre kur ajo përmban koncepte relevante në të cilat Paneli mund të mbështetet për përcaktimin e standardit të vet të shqyrtimit.

²⁶ *Oxford English Dictionary* (OUP, 2021).

²⁷ Shih po kështu, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4, 10-4.12; Pml.Kzz 84/2015, Aktgjykim, 12 maj 2015, f. 2-4; Pml.Kzz 26/2015, Aktgjykim, 18 mars 2015, f. 3-7.

ndikim juridikisht thelbësor mbi vendimin e kundërshtuar.²⁸ Sipas rregullës 193(3) të Rregullores, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë “nuk mund të paraqitet mbi bazën e një përcaktimi të gabuar apo të paplotë lidhur me faktet e çështjes”.²⁹ Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se “thjesht mospajtimi me vlerësimin faktik të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nuk përmbush kushtet për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë”.³⁰ Nuk mjafton që pala thjesht “të paraqesë mospajtimin me aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë ose të përsërisë parashtrimet në ankesat e mëparshme”.³¹

26. Për të vlerësuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur, Paneli i Gjykatës Supreme trajton ato shkelje të ligjit që pretendohen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nuk është e nevojshme që Paneli i Gjykatës Supreme të kryejë shqyrtim *proprio motu* të konstatimeve faktike të Panelit të Gjykatës së Apelit. Paneli do të ndërhyjë në konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit në rast se, siç u shpjegua më lart, shkelja procedurale ka ndikuar ndjeshëm në vendimin e kundërshtuar.³²

27. Nëse Paneli i Gjykatës Supreme konstaton një shkelje të paraparë në nenin 48(7) të Ligjit dhe rregullën 193(3) të Rregullores, ai, në pajtim me rregullën 194(1) të Rregullores:

- (a) modifikon vendimin ose aktgjykimin e kontestuar;
- (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent; ose
- (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.

28. Në vijim, Paneli do të trajtojë arsyet e paraqitura në Kërkesë.

²⁸ Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Plm.Kzz 178/2016, Aktgjykim, 19 dhjetor 2016, para. 67- 68. Në të njëjtën vijë është dhe praktika e tribunalëve penalë ndërkombëtarë, IRMCT, *Prosecutor v. Karadžić*, Case No. MICT-13-55-A, Judgement, 20 March 2019, para. 15; *Prosecutor v. Šešelj*, Case No. MICT-16-99-A, Judgement, 11 April 2018, para. 13; ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, Case No. IT-08-91-A, Judgement, 30 June 2016, para. 18. Shih edhe më lart, para. 22.

²⁹ Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, Pml-Kzz 147/2017, Aktgjykim, 20 korrik 2017, f. 9.

³⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Plm.Kzz 178/2016, Aktgjykim, 19 dhjetor 2016, para. 59.

³¹ Gjykata Supreme e Kosovës, Plm.Kzz 178/2016, Aktgjykim, 19 dhjetor 2016, para. 68.

³² Shih Gjykata Supreme e Kosovës, Plm.Kzz 178/2016, Aktgjykim, 19 dhjetor 2016, para. 68.

IV. DISKUTIM

A. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 5(4) TË KEDNJ-SË PËR SHKAK TË MOSDHËNIES NË KOHË TË VENDIMIT (PIKA 1)

1. Parashtrimet

29. Z. Veseli parashtron se, me lëshimin e vendimit për vazhdimin e paraburgimit të tij gati katër muaj pas apelit, Paneli i Gjykatës së Apelit shkeli të drejtën e tij për vendim të shpejtë mbi ligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të tij, siç përcaktohet në nenin 5(4) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ").³³ Sipas z. Veseli, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") ka konstatuar vazhdimisht se shpejtësia e nxjerrjes së vendimit llogaritet duke filluar nga koha kur u bë kërkesa për lirim dhe përcaktohet mbi bazën e rrethanave individuale të çështjes.³⁴ Z. Veseli pretendon se faktorët e evidentuar nga GJEDNJ-ja për të përcaktuar nëse vendimi u dha shpejt, ³⁵ përkatësisht kompleksiteti i çështjes gjyqësore, sjellja e autoriteteve dhe të akuzuarve dhe interesat përkatëse, tregojnë se Vendimi i Kundërshtuar u dha me vonesë të papërligjur.³⁶

30. ZPS-ja parashtron se z. Veseli keqinterpretonte jurisprudencën e GJEDNJ-së, që përcakton se në procedurat e apelit mund të tolerohen periudha më të gjata për dhënien e vendimeve mbi paraburgimin, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes.³⁷ ZPS-ja parashtron më tej se rishikimi i rregullt i paraburgimit që parashihet në Ligj, është faktor relevant që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të ndonjë vonesa, e drejtë nga e cila z. Veseli hoqi dorë ndërkohë që priste Vendimin e Kundërshtuar.³⁸ ZPS-ja parashtron se Paneli i Gjykatës së Apelit u përball me një shqyrtim veçanërisht

³³ Kërkesa, para. 12-13, 17.

³⁴ Kërkesa, para. 15-16.

³⁵ Kërkesa, para. 16.

³⁶ Kërkesa, para. 18-20. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 5, 8.

³⁷ Përgjigja, para. 17-18, 20-21.

³⁸ Përgjigja, para. 19.

të ndërlikuar, i cili justifikon kohën që mori dhënia e Vendimit të Kundërshtuar.³⁹ Së fundi, sipas ZPS-së, z. Veseli nuk iu shkaktua dëm, pasi Paneli i Gjykatës së Apelit e rrëzoi apelin e tij në tërësi dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake më pas zgjati paraburgimin e tij.⁴⁰

31. Veseli kundërpërgjigjet se ZPS-ja keqinterpretonte jurisprudencën e GJEDNJ-së kur sugjeron se ka përjashtime ndaj “afatit prej 3-4 javësh” për dhënien e vendimeve të shpejta mbi paraburgimin dhe parashtron se Vendimi i Kundërshtuar nuk ishte i ndërlikuar, krahasimisht me vendime të ngjashme që janë lëshuar.⁴¹ Së fundi, z. Veseli parashtron se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk kërkon që ai të demonstrojë se u dëmtua nga vonesa në dhënien e vendimit.⁴²

2. Vlerësimi i Panelit

a. Pranueshmëria e Pikës 1

32. Fillimisht, Paneli thekson se z. Veseli nuk pretendon shkelje thelbësore të nenit 41(2) të Ligjit, sipas të cilit i akuzuari ka të drejtë që të paraqesë ankesë në lidhje me kushtet e paraburgimit dhe që vendimi përkatës të jepet shpejt. Në vend të kësaj, z. Veseli mbështetet në nenin 48(8) të Ligjit për të vërtetuar pretendimin e tij se është shkelur neni 5(4) i KEDNJ-së.⁴³

33. Paneli rikujton se, sipas nenit 48(7)(b) të Ligjit, pala që kërkon mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të paraqesë pretendime për shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe në Rregullore. Me fjalë të tjera, në kontekstin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, pala nuk mund t’i referohet vetëm një shkeljeje të KEDNJ-së ose Kushtetutës, përveç nëse këto të drejta që parashikohen në to janë të përfshira drejtpërdrejt në Ligj dhe/ose Rregullore. Rrjedhimisht, është e mundur që Paneli ta

³⁹ Përgjigja, para. 20.

⁴⁰ Përgjigja, para. 22.

⁴¹ Kundërpërgjigja, para. 4, 7. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 6.

⁴² Kundërpërgjigja, para. 9.

⁴³ Kërkesa, para. 12-21.

rrëzojë këtë Pikë të Kërkesës si të papranueshme.

34. Megjithatë, Paneli vë në dukje se neni 41(2) i Ligjit pasqyron formulimin e nenit 5(4) të KEDNJ-së dhe, rrjedhimisht, Kërkesa trajton një të drejtë të përcaktuar në Ligj. Për rrjedhojë, Paneli do të shqyrtojë, si rast përjashtimor, themelësinë e Pikës 1, bazuar në nenin 41(2) të Ligjit. Siç përcaktohet në nenin 3(2)(d) të Ligjit, Paneli do të japë gjykimin e tij për këtë Pikë në përputhje me KEDNJ-në dhe do të udhëhiqet nga jurisprudenca e GJEDNJ-së që lidhet me nenin 5(4) të KEDNJ-së.

b. Themelësia

35. Kriteri për dhënien e një vendimi të shpejtë mbi rishikimin e paraburgimit, vlen si për shkallën e parë, d.m.th për Gjykatësin e Procedurës Paraprake ose Trupin Gjykues të ngarkuar me gjykimin e çështjes, ashtu edhe për Panelin e Gjykatës së Apelit në shkallë të dytë.⁴⁴ GJEDNJ-ja ka konstatuar se “kur urdhri fillestar i paraburgimit është lëshuar nga një gjykatë (domethënë, nga një organ gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm) në një procedurë që ofron garancitë e duhura të procesit ligjor të rregullt, dhe kur [ka një sistem apeli], [GJEDNJ-ja] është e gatshme të tolerojë periudha më të gjata shqyrtimi në procedurat para gjykatës së shkallës së dytë”.⁴⁵

36. Koha që merr lëshimi i vendimit mbi rishikimin e paraburgimit ndryshon në varësi të rrethanave individuale të çështjes.⁴⁶ GJEDNJ-ja ka konstatuar se termi “i shpejtë” nuk mund të përkufizohet në kontekst abstrakt” dhe se “ai duhet të përcaktohet bazuar në rrethanat e çështjes përkatëse”.⁴⁷ Për këtë qëllim, GJEDNJ-ja ka shpjeguar se vlerësimi i kohës së marrë për dhënien e vendimit mbi paraburgimin,

⁴⁴ Shih ECtHR, *Ilseher v. Germany* [GC], Nos 10211/12 and 27505/15, Judgment, 4 December 2018 (“*Ilseher case*”), para. 254 (dhe citimet aty).

⁴⁵ ECtHR, *Ilseher case*, para. 255; *Abdulkhakov v. Russia*, No. 14743/11, Judgment, 2 October 2012, para. 198; *Khudyakova v. Russia*, No. 13476/04, Judgment, 8 January 2009, para. 93; *Lebedev v. Russia*, No. 4493/04, Judgment, 25 October 2007, para. 96.

⁴⁶ Shih ECtHR, *Ilseher case*, para. 255; *Fešar v. the Czech Republic*, No. 76576/01, Judgment, 13 November 2008, para. 68; *Stephens v. Malta* (no. 2), No. 33740/06, Judgment, 21 April 2009, para. 84.

⁴⁷ ECtHR, *R.M.D. v. Switzerland*, No. 81/1996/700/892, Judgment, 26 September 1997, para. 42.

duhet të mbajë parasysh vlerësimin e përgjithshëm të procedurave në të gjitha nivelet gjyqësore,⁴⁸ si dhe mund të merren parasysh faktorë të tillë si kompleksiteti i procesit, sjellja e autoriteteve dhe e paditësit, dhe çfarë rrezikon ky i fundit.⁴⁹ Për shembull, në çështjen *Ilseher*, në të cilën mbështetet z. Veseli,⁵⁰ GJEDNJ-ja konstatoi se tetë muajt e 23 ditët që iu deshën Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë për të dhënë vendim mbi një aspekt që kishte lidhje me paraburgimin, nuk shkeli nenin 5(4) të KEDNJ-së, për shkak të ndërlikimeve të veçanta të asaj çështjeje dhe natyrën e asaj gjykate.⁵¹

37. Duke iu kthyer rrethanave konkrete të çështjes aktuale, Paneli vëren fillimisht se Kërkesa lidhet me një shqyrtim në shkallë të dytë, domethënë, drejtohet kundër Vendimit të Kundërshtuar të Panelit të Gjykatës së Apelit. Paneli vëren se procedurat e paraburgimit në rastin e z. Veseli, që çuan në Vendimin e Kundërshtuar, ishin më të ndërlikuara se rishikimet pararendëse të paraburgimit. Kompleksiteti i veçantë ligjor dhe faktik i këtij apeli u pranua edhe nga z. Veseli, i cili argumentoi para Panelit të Gjykatës së Apelit se kompleksiteti dhe risia e çështjeve të paraqitura në Vendimin e Tretë për Paraburgimin përligjnin miratimin e shtimit të numrit të lejuar të fjalëve për paraqitjen e apelit të tij kundër këtij vendimi.⁵²

38. Paneli vëren se Paneli i Gjykatës së Apelit kreu shqyrtim të hollësishëm të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe e ktheu çështjen për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës mund t'i zbatonte në mënyrë efektive kushtet e paraburgimit të propozuara nga z. Veseli, ose çdo kusht tjetër që Gjykatësi i Procedurës Paraprake

⁴⁸ ECtHR, *Ilseher case*, para. 255.

⁴⁹ ECtHR, *Ilseher case*, para. 255.

⁵⁰ Shih Kërkesa, para. 14-18.

⁵¹ ECtHR, *Ilseher case*, paras 257, 262-263, 265.

⁵² KSC-BC-2020-06/IA014/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, 2 dhjetor 2021, para. 5-6 ("[Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin] – me gjithsej 46 faqe – trajton çështje të ndërlikuara ligjore me rëndësi të madhe, të cilat Mbrojtja duhet t'i trajtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Apeli i Mbrojtjes duhet të trajtojë jo vetëm aspektet e shumta që burojnë nga [Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin] por edhe një mori parashtrimesh të palëve dhe Policisë së Kosovës ku u mbështet Vendimi"). Shih gjithashtu paragrafët 7 dhe 8 të Kërkesës së z. Veseli.

e evidenton si të domosdoshëm për zvogëlimin e rreziqeve që shoqërojnë arrestin shtëpiak.⁵³ Pas kësaj, Paneli i Gjykatës së Apelit duhet të shqyrtonte vendimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake bazuar në informacionin e dhënë nga Policia e Kosovës,⁵⁴ parashtrimet e palëve në lidhje me të, si dhe pikat komplekse ligjore dhe faktike të paraqitura nga z. Veseli në Apelin e tij.⁵⁵ Në Vendimin e Kundërshtuar Paneli i Gjykatës së Apelit dha arsyetim të gjatë dhe të hollësishëm dhe iu referua gjerësisht procedurave dhe informacionit që kishte marrë parasysh.⁵⁶

39. Paneli vëren se në çështjen *Ilseher*, GJEDNJ-ja mori parasysh zhvillimin në përgjithësi të procesit, përfshirë dhënien e vendimeve të ndërmjetme të arsyetuara mbi paraburgimin e paditësit, si dhe mundësinë e paditësit në atë çështje që paraburgimi i tij të rishikohej nga gjykata e shkallës më të ulët, ndërkohë që ende pritej vendimi i gjykatës më të lartë.⁵⁷ GJEDNJ-ja i mori parasysh këta faktorë kur arriti në përfundimin se, në rrethanat e asaj çështjeje mund të tolerohej koha më e gjatë e marrë për lëshimin e vendimit mbi paraburgimin.⁵⁸

40. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara parashikon rishikimin e rregullt të paraburgimit.⁵⁹ Faktikisht, paraburgimi i z. Veseli është rishikuar rregullisht.⁶⁰ Vendimi më i fundit mbi paraburgimin e tij u dha nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 korrik 2022, gjatë shqyrtimit *sub judice* të Kërkesës aktuale.⁶¹ Gjithashtu, Paneli vë në dukje se z. Veseli vendosi vullnetarisht të heqë dorë nga e drejta e rishikimit të paraburgimit ndërkohë që pritej vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit për apelin e tij. Paneli është bindur se në Dhomat e Specializuara

⁵³ Vendimi i Dytë i Apelit, para 52, 54.

⁵⁴ Shih F00548/eng, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Përgjigje në Kërkesë me Numër KSC-BC-2020-06, 27 tetor 2021 (konfidenciale). Përkthimi në anglisht i këtij parashtrimi u dorëzua më 3 nëntor 2021.

⁵⁵ Shih përgjithësisht Apeli.

⁵⁶ Shih Vendimi i Kundërshtuar, paras 20-26, 34-44, 49-52, 56-57, 61-66.

⁵⁷ Shih ECtHR, *Ilseher case*, paras 269, 275.

⁵⁸ ECtHR, *Ilseher case*, para. 275.

⁵⁹ Shih Neni 41(2)(10) i Ligjit; Rregulla 57 e Rregullores.

⁶⁰ Shih Vendimi i Katërt për Paraburgimin dhe Vendimi i Pestë për Paraburgimin .

⁶¹ F00897, Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 26 korrik 2022.

funksionon një sistem rigoroz dhe se vendimi për vazhdimin e paraburgimit i lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ofron garancitë e duhura të procesit ligjor të rregullt.⁶² Paneli gjykon se rishikimi i rregullt i paraburgimit të z. Veseli dhe vendimet e arsyetuara përkatëse, janë faktorë që duhen mbajtur parasysh në vlerësimin e përgjithshëm të Panelit të shpejtësisë së dhënies së Vendimit të Kundërshtuar.

41. Paneli gjithashtu vë në dukje pikëpamjen e GJEDNJ-së se ndërlikimet që paraqet një çështje e veçantë, ndonëse nuk i lirojnë autoritetet nga detyrimet themelore të tyre sipas nenit 5(4) të KEDNJ-së, mund të jenë një faktor kur vlerësohet shpejtësia.⁶³ Në këtë aspekt, Paneli vëren se ndaj z. Veseli janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit nga një gjykatë që është zhvendosur në Holandë për shkak aspekteve të ndjeshme të procesit gjyqësor, si dëgjimi i dëshmitarëve dhe natyra e veçantë e akuzave.⁶⁴ Ishte në këtë kontekst që Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrtuan në hollësi aspekte të ndjeshme dhe të ndërlikuara që përfshijnë frikësimin e dëshmitarëve të mundshëm në Kosovë, kur vlerësuan paraburgimin e z. Veseli dhe ndërlikimet që lidhen me lirimin e tij të mundshëm nga objekti i paraburgimit në Hagë në Kosovë.⁶⁵ Paneli gjykon se këta janë faktorë të rëndësishëm dhe relevantë në vlerësimin e kohës që mori Paneli i Gjykatës së Apelit për të dhënë Vendimin e Kundërshtuar.

42. Paneli vëren se periudha pothuaj prej katër muajsh që mori Paneli i Gjykatës së Apelit për të dhënë Vendimin e Kundërshtuar, në pamje të parë mund të mos konsiderohet e shpejtë sipas kuptimit të nenit 41(2) të Ligjit. Megjithatë, pasi ka vlerësuar me kujdes të gjithë faktorët e përmendur më lart, Paneli gjykon se koha që

⁶² Shih ECtHR, *Mehmet Hasan Altan v. Turkey*, No. 13237/17, Judgment, 20 March 2018, para. 165; *Ilseher case*, paras 271, 274; *Molotchko v. Ukraine*, No. 12275/10, Judgment, 26 April 2012, para. 148; *Letellier v. France*, No. 12369/86, Judgment, 26 June 1991, para. 56.

⁶³ Shih ECtHR, *Ilseher case*, para. 253.

⁶⁴ Shih Ligjin Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, 23 prill 2014.

⁶⁵ Shih, p.sh., Vendimin e Tretë mbi Paraburgimin, para. 43-61; Vendimin e Kundërshtuar, para. 21-67.

mori Paneli i Gjykatës së Apelit për të dhënë Vendimin e Kundërshtuar ishte e përligjur në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, dhe konstaton se nuk ka shkelje të nenit 41(2) i Ligjit. Rrjedhimisht, z. Veseli nuk ka evidentuar ekzistencën e një shkeljeje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore, sipas kuptimit të nenit 48(7)(b) të Ligjit.

**B. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENEVE 5(3) DHE (4) TË KEDNJ-SË PËR SHKAK TË
MOSTRAJTIMIT TË PARASHTRIMEVE DHE MOSRESPEKTIMIT TË SË DREJTËS PËR PROCES
BALLAFAQUES (PIKAT 2 DHE 3)**

1. Parashtrimet

43. Z. Veseli pretendon se Paneli i Gjykatës së Apelit shkeli të drejtën e tij për proces ballafaques sipas nenit 5(4) të KEDNJ-së, sepse u mbështet në pretendime të paraqitura në procedurë *ex parte* për të faktuar vazhdimin e paraburgimit të tij.⁶⁶ Në veçanti, z. Veseli parashtroi se Paneli i Gjykatës së Apelit gaboi që rrëzoi argumentet e tij se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhej të ishte mbështetur në pretendimet *ex parte* të ZPS-së në lidhje me fletarrestimin e z. Veseli, në të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet më pas si faktor për të vendosur vazhdimin e paraburgimit të tij.⁶⁷

44. Z. Veseli parashtroi më tej se arsyetimi i Panelit të Gjykatës së Apelit në Vendimin e Kundërshtuar kishte mangësi, pasi nuk trajtoi “thelbin” e argumenteve të tij⁶⁸ dhe ishte arsyetim i pamjaftueshëm.⁶⁹ Gjithashtu, z. Veseli nuk pajtohet me vlerësimin e Panelit të Gjykatës së Apelit të provave dhe rrethanave faktike ku u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të tij.⁷⁰

⁶⁶ Kërkesa, para. 22, 25. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 23, 26, 28.

⁶⁷ Kërkesa, para. 24. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 10-11.

⁶⁸ Kërkesa, para. 25-27, 37, 60-61, 63.

⁶⁹ Kërkesa, para. 36, 62. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 12-13, 15, 17-18.

⁷⁰ Kërkesa, para. 28-35, 38, 58.

45. ZPS-ja përgjigjet, ndër të tjera, se në kundërshtim me pretendimet e z. Veseli në Pikën 2, ajo i ngriti pretendimet në parashtrimet e saj gjatë rishikimit të paraburgimit që u krye në nëntor 2021, por z. Veseli zgjodhi të mos i kundërshtonte këto pretendime deri në rishikimin e tretë të paraburgimit.⁷¹ ZPS-ja gjithashtu parashtron se argumentet e z. Veseli të paraqitura në Pikat 2 dhe 3 u shqyrtuan nga Paneli i Gjykatës së Apelit dhe, gjithsesi, kundërshtimet ndaj vlerësimeve mbi faktet nuk mund t'i bashkëngjiten një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.⁷² Rrjedhimisht, ZPS-ja pretendon se këto argumente duhet të rrëzohen.⁷³

46. Z. Veseli kundërpërgjigjet, ndër të tjera, se kundërshtimet e tij të paraqitura në Pikën 2 janë bërë në kohën e duhur, pasi ato, në kuptimin e ngushtë të fjalës, i drejtohen Vendimit të Kundërshtuar, e jo Vendimit të Tretë për Paraburgimin.⁷⁴

2. Vlerësimi i Panelit

a. Pranueshmëria e Pikës 2 dhe 3

47. Paneli thekson se z. Veseli nuk vë në pah ndonjë shkelje thelbësore të ndonjë procedure konkrete të Ligjit ose Rregullores, por vetëm i referohet në mënyrë të përgjithshme të drejtës për proces ballafaques të garantuar në nenin 5(3) dhe (4) të KEDNJ-së.⁷⁵ Siç u përmend më lart,⁷⁶ Paneli do të bëjë përjashtim dhe do ta trajtojë këtë Pikë të Kërkesës, duke qenë se kjo është hera e parë që paraqitet një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka të bëjë me paraburgimin e një të akuzuari.

48. Paneli gjithashtu rikujton se kur merr vendim mbi një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ai nuk vepron si shkallë e dytë shqyrtimi i konstatimeve faktike të Panelit të Gjykatës së Apelit. Në vend të kësaj, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është një

⁷¹ Përgjigjja, para. 25. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 23-29.

⁷² Përgjigjja, para. 30-33, 35-37.

⁷³ Përgjigjja, para. 34.

⁷⁴ Kundërpërgjigjja, para. 14.

⁷⁵ Kërkesa, para. 24-28, që i referohen ECtHR, *Reinprecht v. Austria*, No. 67175/01, Judgment, 15 November 2005, para. 31.

⁷⁶ Shih më lart, para. 33-34.

mjet juridik i jashtëzakonshëm vetëm në lidhje me pretendimet për shkelje ligjore.⁷⁷ Thjesht mospajtimi me vlerësimet faktike ose kundërshtimet në lidhje me plotësinë e vlerësimit të Panelit, nuk mund të jenë bazë për një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.⁷⁸

49. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se parashtrimet e Veselit në Pikat 2 dhe 3 janë tërësisht të llojit faktik dhe iu paraqitën edhe Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Gjykatës së Apelit.⁷⁹ Ndonëse z. Veseli mund të mos pajtohet me rezultatin e vlerësimeve apo shkallën e trajtimit të argumenteve të tij në to, Paneli gjykon se si Gjykatësi i Procedurës Paraprake ashtu dhe Paneli i Gjykatës së Apelit, i shqyrtuan me kujdes parashtrimet e z. Veseli dhe dhanë hollësi të mjaftueshme në vlerësimet e tyre.⁸⁰

⁷⁷ Shih më lart, para. 21. Shih gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 42/2017, 10 maj 2017, para. 23; Pml.Kzz 72/2015, Aktgjykim, 13 tetor 2015, para. 3.2.

⁷⁸ Shih rregullën 193(3) të Rregullores. Shih gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 236/2016, Aktgjykim, 11 janar 2017, para. 8 (f. 9-10); Pml.Kzz 322/2016, Aktgjykim, 19 korrik 2017, para. 126, 175; Pml.Kzz 241/2015, 19 prill 2016, para. 38; Pml.Kzz 72/2015, Aktgjykim, 13 tetor 2015, para. 3.2.

⁷⁹ **Pika 2:** KSC-BC-2020-06/F00151, Kërkesë për Lirim të Përkohshëm të Kadri Veselit, 17 dhjetor 2020, para. 25-27 ("Kërkesa për Lirim të Përkohshëm"); KSC-BC-2020-06/F00174, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës së Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm, 13 janar 2021 ("Kundërpërgjigja e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm"), para. 39-43; KSC-BC-2020-06, IA014/F00004, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 3 dhjetor 2021 (konfidencial) ("Apeli kundër Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin"), para. 8-9, 12; KSC-BC-2020-06/IA014/F00007, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Rishqyrtimin e Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Kadri Veselit, 21 dhjetor 2021, konfidenciale ("Kundërpërgjigja ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Mbrojtjes së Veselit"), para. 2-3. **Pika 3:** Kërkesë për Lirim të Përkohshëm, para. 28-35, 36-42; Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës për Lirim të Përkohshëm, paras 29-34; KSC-BC-2020-06/IA001/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes për Apelimin e Vendimit mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm, 1 shkurt 2021, para. 16-18; KSC-BC-2020-06/IA008/F00001, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit KSC-BC-2020-06-F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit), 15 korrik 2021 (konfidencial), para. 7; Apeli kundër Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin, para. 10-12, 21; Kundërpërgjigja ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Veselit, para. 4.

⁸⁰ Shih **Pikën 2:** Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 52-53; Vendimi i Kundërshtuar, para. 17-24; **Pikën 3:** Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 44; Vendimi i Parë i Apelit, para. 36-40; Vendimi i Dytë i Apelit, para. 34; Vendimi i Kundërshtuar, para. 25, 39. Shih gjithashtu Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 236/2016, Aktgjykim, 11 janar 2017, para. 10 (p. 10); PML-241/2015, 19 prill 2016, para. 39; Pml.Kzz 7/2015, Aktgjykim, 23 janar 2015, para. 3.3-3.4; Pml.Kzz 72/2015, Aktgjykim, 13 tetor 2015, para. 3.2; Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4.2.

50. Për shembull, në Pikën 2, z. Veseli parashtroi se i ishte shkelur e drejta për proces ballafaques kur Paneli i Gjykatës së Apelit u mbështet në pretendimet e paraqitura në një procedurë *ex parte*.⁸¹ Në mënyrë të ngjashme, në Pikën 3, z. Veseli kundërshtoi interpretimin e argumenteve të tij nga Paneli i Gjykatës së Apelit, që, sipas Veselit, ka të bëjë me peshën që duhet t'i jepet njërit prej faktorëve që merren parasysh kur vlerësohet nëse ende ekziston rreziku për ndërhyrje.⁸² Në këtë aspekt, Paneli thekson se, kur vendosën vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli, si Gjykatësi i Procedurës Paraprake ashtu dhe Paneli i Gjykatës së Apelit, morën parasysh një mori faktorësh, nga të cilët këta faktorë përbëjnë vetëm një aspekt.⁸³ Thelbi i këtyre argumenteve është faktikisht, mospajtimi me vlerësimin diskrecional që u bënë fakteve Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së.

51. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Pikat 2 dhe 3 janë të papranueshme dhe i hedh poshtë në tërësi ato.

C. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 41(12) TË LIGJIT DHE NENIT 5(3) TË KEDNJ-SË

LIDHUR ME VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT (PIKA 4)

1. Parashtrimet

52. Z. Veseli parashtroi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit shkelën nenin 41(12) të Ligjit dhe nenin 5(3) të KEDNJ-së kur vendosën kushte të paarsyeshme dhe joproporcionale paraburgimi lidhur me rrezikun e evidentuar.⁸⁴ Z. Veseli parashtroi se Paneli i Gjykatës së Apelit fillimisht e ktheu çështjen për të përcaktuar zbatueshmërinë e masave që do të ndërmernte Policia e Kosovës dhe më pas la në fuqi Vendimin e Tretë për Paraburgimin, në të cilin u konstatua se këto masa ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e ndërhyrjes

⁸¹ Shih Kërkesën, para. 22-35.

⁸² Kërkesa, para. 36-38.

⁸³ Vendimi i Tretë për Paraburgimin, para. 30-41; Vendimi i Kundërshtuar, para. 21, 27.

⁸⁴ Kërkesa, para. 39-54. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 21-22.

ndaj dëshmitarëve nëse z. Veseli do të lirohej përkohësisht me kushte të caktuara.⁸⁵ Z. Veseli parashtroi se konstatimi kontradiktor i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se “asnjë masë shtesë e urdhëruar *proprio motu* nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rrezikun ekzistues”, pavarësisht nga zbatueshmëria e masave të Policisë së Kosovës, mjafton për të bërë të pavlefshëm Vendimin e Kundërshtuar.⁸⁶

53. Z. Veseli parashtroi më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit bënë gabim ligjor që masat e propozuara nga Policia e Kosovës në kontekstin e arrestit shtëpiak të z. Veseli i konsideruan si “të përcaktuara përfundimisht” dhe që nuk mund të ndryshoheshin nga Dhomat e Specializuara.⁸⁷

54. ZPS-ja përgjigjet se argumentet e z. Veseli janë me natyrë faktike dhe kundërshtojnë përfundimet diskrecionale pa provuar ndonjë shkelje të Ligjit apo Rregullores.⁸⁸ Sipas ZPS-së, Paneli i Gjykatës së Apelit zbatoi saktë standardin e tij të shqyrtimit dhe z. Veseli thjesht nuk pajtohet me përfundimet e arritura.⁸⁹ ZPS-ja gjithashtu parashtroi se pretendimet e z. Veseli lidhur me masat shtesë që mund të ishin urdhëruar, kanë të bëjnë me vendime të marra më shumë se 90 ditë më parë dhe, rrjedhimisht, të papranueshme.⁹⁰ Së fundi, sipas ZPS-së, z. Veseli keqinterpretonte rrethanat e çështjes dhe thjesht nuk pajtohet me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të konfirmuar më pas nga Paneli i Gjykatës së Apelit, se rreziqet që paraqet lirimi i z. Veseli nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me kushtet e arrestit shtëpiak në Kosovë.⁹¹ Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtroi se Pika 4 duhet të hidhet poshtë.⁹²

55. Z. Veseli kundërpërgjigjet, ndër të tjera, se i ka paraqitur argumentet e tij në kohën e duhur pasi ato drejtohen kundër Vendimit të Kundërshtuar, i cili duhet të

⁸⁵ Kërkesa, para. 40-43.

⁸⁶ Kërkesa, para. 44. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 54.

⁸⁷ Kërkesa, para. 45-47.

⁸⁸ Përgjigja, para. 38.

⁸⁹ Përgjigja, para. 39-43.

⁹⁰ Përgjigja, para. 44.

⁹¹ Përgjigja, para. 47-50.

⁹² Përgjigja, para. 51.

shqyrtohet duke pasur parasysh Vendimin e Tretë për Paraburgimin.⁹³

2. Vlerësimi i Panelit

a. Pranueshmëria e Pikës 4

56. Siç u përmend më lart, Paneli nuk mund të bëjë vlerësim të konstatimeve faktike të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me proporcionalitetin apo arsyeshmërinë e masave të propozuara për zvogëlimin e rrezikut të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁹⁴ Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit i shqyrtuan gjerësisht argumentet e z. Veseli në këtë aspekt.⁹⁵ Rrjedhimisht, argumentet e z. Veseli kundër konstatimeve faktike të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me arsyeshmërinë ose proporcionalitetin e masave të propozuara për t'u zbatuar në kuadër të arrestit shtëpiak, hidhen poshtë.⁹⁶

57. Lidhur me argumentet e z. Veseli për autoritetin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të urdhëruar Policinë e Kosovës që të zbatojë çfarëdo mase që ai e gjykon të nevojshme,⁹⁷ Paneli vëren se z. Veseli nuk evidenton ndonjë procedurë në Ligj apo Rregullore që të jetë shkelur në mënyrë thelbësore. Në vend të kësaj, z. Veseli shpreh mospajtim me mënyrën e ushtrimit të diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në këtë çështje. Argumentet e z. Veseli, në parim, duhet të hidhen poshtë. Megjithatë, në përputhje me qasjen e përdorur më lart,⁹⁸ në rrethanat aktuale, Paneli do të bëjë përjashtim dhe do të shqyrtojë themelësinë e kësaj Pike.

b. Themelësia

⁹³ Kundërpërgjigjja, para. 20.

⁹⁴ Shih rregullën 193(3) e Rregullores. Shih, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 236/2016, Aktgjykim, 11 janar 2017, para. 8 (f. 9-10), 18 (p. 12); Pml.Kzz 246/2014, Aktgjykim, 15 dhjetor 2014, para. 3.3.

⁹⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 35-38, 40-41, 43-44.

⁹⁶ Shih Kërkesën, para. 48-54.

⁹⁷ Kërkesa, para. 45-47.

⁹⁸ Shih më lart, para. 33-34.

58. Neni 41(12) i Ligjit përfshin një listë masash, krahas paraburgimit, që mund të urdhërohen nga Dhomat e Specializuara për të siguruar praninë e të akuzuarit në procedurat gjyqësore, si arresti shtëpiak në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet të marrë pjesë në proces përmes videolidhjes. Paneli vëren se neni 41(12) i Ligjit i jep Gjykatësit të Procedurës Paraprake diskrecionin të vendosë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme për një arrest të mundshëm shtëpiak.

59. Paneli vëren se në Vendimin e Dytë të Apelit, Paneli i Gjykatës së Apelit ia ktheu çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës mund të zbatonte kushte shtesë.⁹⁹ Paneli i Gjykatës së Apelit shpjegoi gjithashtu se informacioni shtesë nga Policia e Kosovës do t'i jepte Gjykatësit të Procedurës Paraprake “një bazë faktike më të plotë dhe më solide për vlerësimin e mundësisë së zbatimit të këtyre kushteve, natyrisht pa paracaktuar rezultatin e vendimit përfundimtar për këto çështje.”¹⁰⁰ Me fjalë të tjera, Paneli i Gjykatës së Apelit nuk kundërshtoi vetveten, siç sugjeron z. Veseli,¹⁰¹ kur në Vendimin e Kundërshtuar konstatoi se përfundimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të bazuara në këtë informacion, ishin të arsyeshme.¹⁰²

60. Në këtë aspekt, Paneli vëren se Paneli i Gjykatës së Apelit shpjegoi standardin e përdorur në shqyrtim dhe më pas bëri vlerësim të detajuar të argumenteve të z. Veseli në lidhje me to.¹⁰³ Në përputhje me standardin e shqyrtimit, si dhe me nenin 41(12) të Ligjit, Paneli i Gjykatës së Apelit arriti në përfundimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri konstatim të gabuar lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të propozuara. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk shkeli procedurën e përcaktuar në Ligj dhe Rregullore dhe, për rrjedhojë, hedh poshtë

⁹⁹ Vendimi i Dytë i Apelit, para. 52.

¹⁰⁰ Vendimi i Dytë i Apelit, para. 52.

¹⁰¹ Kërkesa, para. 39.

¹⁰² Vendimi i Kundërshtuar, para. 57.

¹⁰³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 16, 34-44.

pjesën e mbetur të argumenteve të Pikës 4.

D. PRETENDIMI PËR SHKELJE NGA PANELI I GJYKATËS SË APELIT NË VLERËSIMIN *PROPRIO MOTU* TË MASAVE SHITESË (PIKA 5)

1. Parashtrimet

61. Z. Veseli parashtron se Paneli i Gjykatës së Apelit, pa bazë ligjore, kufizoi kompetencën *proprio motu* të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të propozuar masa shtesë.¹⁰⁴ Z. Veseli gjithashtu pretendon se Paneli i Gjykatës së Apelit “gabo” që u mbështet në natyrën e përgjigjes së Policisë së Kosovës kur vendosi të mos urdhëronte *proprio motu* masa shtesë në lidhje me arrestin e mundshëm shtëpiak.¹⁰⁵

62. ZPS-ja përgjigjet se kompetenca *proprio motu* e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të shqyrtuar kushte shtesë të lirimit kufizohet në ato kushte që janë “të arsyeshme”.¹⁰⁶ ZPS-ja parashtron se, në kundërshtim me argumentet e z. Veseli, është “logjike” që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mbështetet në parashtrimet e palëve kur shqyrton *proprio motu* të gjitha masat e arsyeshme dhe kjo përputhet me deklaratimet e Panelit të Gjykatës së Apelit për këtë aspekt.¹⁰⁷ Rrjedhimisht, ZPS-ja pretendon se Pika 5 duhet të hidhet poshtë.¹⁰⁸

2. Vlerësimi i Panelit

a. Pranueshmëria e Pikës 5

63. Fillimisht, Paneli vëren se z. Veseli nuk përmend shkelje thelbësore të ndonjë procedure specifike të Ligjit ose Rregullores.¹⁰⁹ Në vend të kësaj, z. Veseli i referohet një konstatimi të Panelit të Gjykatës së Apelit, për të cilin z. Veseli parashtron në

¹⁰⁴ Kërkesa, para. 56-57; Kundërpërgjigja, para. 23.

¹⁰⁵ Kërkesa, para. 58-59; Kundërpërgjigja, para. 24.

¹⁰⁶ Përgjigja, para. 53. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 52.

¹⁰⁷ Përgjigja, para. 55. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 56-58.

¹⁰⁸ Përgjigja, para. 59.

¹⁰⁹ Kërkesa, para. 55-59.

mënyrë të përgjithshme se buron nga “detyrimet sipas Kushtetutës dhe GJEDNJ-së lidhur me prezumimin e lirisë dhe përdorimin e paraburgimit vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe si mjet i fundit”.¹¹⁰ Z. Veseli gjithashtu parashtroi se Paneli i Gjykatës së Apelit shkeli vetë vendimin e vet, kur konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi masa shtesë *proprio motu*.

64. Sipas Panelit, z. Veseli nuk evidenton se cilat janë procedurat specifike në Ligj ose Rregullore dhe nuk shpjegon se si vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit përbën shkelje thelbësore të tyre.¹¹¹ Për më tepër, Paneli i Gjykatës së Apelit i shqyrtoi argumentet e z. Veseli në lidhje me kuadrin e caktimit *proprio motu* nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të masave shtesë që mund të vendoseshin si pjesë e arrestit të mundshëm shtëpiak, dhe i hodhi poshtë ato.¹¹² Mospajtimi i z. Veseli me konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për mënyrën se si mund të vendosë *proprio motu* masa shtesë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nuk përbën shkelje thelbësore të procedurave sipas nenit 48(7)(b) të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë si të papranueshme argumentet e z. Veseli të parashtruara në Pikën 5.

E. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË RREGULLËS 56(2) TË RREGULLORES NGA PANELI I

GJYKATËS SË APELIT NË LIDHJE ME PROPORCIONALITETIN E PARABURGIMIT (PIKA 6)

1. Parashtrimet

65. Z. Veseli pretendon se Paneli i Gjykatës së Apelit gaboi që thjesht iu referua faktorëve që mori parasysh nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kur konstatoi se z. Veseli duhet të qëndronte në paraburgim dhe nuk trajtoi argumentet ligjore të z. Veseli në lidhje me arsyeshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të tij.¹¹³ Konkretisht, z. Veseli parashtroi se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk i trajtoi argumentet e tij se jurisprudenca e GJEDNJ-së kërkon që, me kalimin e kohës, duhet të jepen arsye të

¹¹⁰ Kërkesa, para. 56.

¹¹¹ Shih, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 159/2016, Aktgjykim, 5 tetor 2016, para. 20.

¹¹² Vendimi i Kundërshtuar, para. 57.

¹¹³ Kërkesa, para. 60-61. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 62-64.

mëtejshme për të përligjur vazhdimin e paraburgimit, peshën që u jep akuzave Gjykatësi i Procedurës Paraprake, si dhe argumentet *pro forma* lidhur me kompleksitetin e çështjes.¹¹⁴ Z. Veseli parashtron më tej se Paneli i Gjykatës së Apelit nuk i shqyrtoi si duhet parashtrimet e tij lidhur me interpretimin e pasaktë të rregullës 56(2) të Rregullores nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjë që, sipas z. Veseli, përbën shkelje të nenit 48(7)(b) të Ligjit.¹¹⁵

66. ZPS-ja parashtron se z. Veseli nuk demonstroi se si Paneli i Gjykatës së Apelit nuk i shqyrtoi si duhet argumentet e tij dhe se “thjesht mospajtimet” e z. Veseli me konstatimet e Panelit të Gjykatës së Apelit nuk mund të konsiderohen “gabim ligjor ose shkelje e të drejtave”.¹¹⁶

2. Vlerësimi i Panelit

a. Pranueshmëria e Pikës 6

67. Sipas z. Veseli, argumentet e tij nxjerrin në pah shkelje thelbësore të procedurave të parashikuara në Ligj dhe Rregullore, sikurse përcaktohet në nenin 48(7)(b) të Ligjit. Megjithatë, Paneli thekson se z. Veseli nuk eidenton ndonjë shkelje thelbësore të një procedure konkrete të Ligjit ose Rregullores. Siç u përmend më lart,¹¹⁷ Paneli do të bëjë përjashtim dhe do ta trajtojë këtë Pikë të Kërkesës, duke qenë se parashtrimet e z. Veseli mund të kuptohen si kundërshtime që ngrenë pretendime për shkelje të procedurave në Ligj dhe Rregullore. Sidoqoftë, Paneli rikujton gjithashtu se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk do të shqyrtohet nëse përbën thjesht mospajtim me vlerësimet faktike të paneleve të tjera.¹¹⁸

68. Paneli vëren se Paneli i Gjykatës së Apelit i shqyrtoi specifikisht argumentet e

¹¹⁴ Kërkesa, para. 60-61.

¹¹⁵ Kërkesa, para. 62-64. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 26.

¹¹⁶ Përgjigja, para. 60. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 61-66.

¹¹⁷ Shih më lart, para. 33-34.

¹¹⁸ Shih rregullën 193(3) e Rregullores. Shih gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës, Pml.Kzz 42/2017, 10 maj 2017, para. 23.

si

z. Veseli në lidhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi ndikimin e kalimit të kohës në vlerësimin nëse paraburgimi vijonte të ishte i arsyeshëm, si dhe argumentet e tij lidhur me interpretimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake të rregullës 56(2) të Rregullores.¹¹⁹ Në këtë aspekt, Paneli i Gjykatës së Apelit vërejti se shqyrtimi i “arsyeve të vlefshme” nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjatë rishikimit të paraburgimit të z. Veseli, ishte veç një prej faktorëve që u morën parasysh në vlerësimin e përgjithshëm të Gjykatës të Procedurës Paraprake.¹²⁰ Së fundi, pavarësisht nga sa më sipër, Paneli i Gjykatës së Apelit nuk është i detyruar “të japë përgjigje të detajuar për çdo argument”, për sa kohë që janë trajtuar aspektet thelbësore të ngritura.¹²¹

69. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Paneli i Gjykatës së Apelit iu përmbajt procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore dhe se argumentet e z. Veseli drejtohen kundër përfundimeve faktike të Gjykatës të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Gjykatës së Apelit, pas vlerësimit të faktorëve relevantë prej tyre. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë Pikën 6 si të papranueshme.

V. VENDIM

70. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Gjykatës Supreme **RRËZON** Kërkesën në tërësi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse

E hënë, 15 gusht 2022

Në Hagë, Holandë.

¹¹⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 63-66.

¹²⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 66.

¹²¹ Gjykata Supreme e Kosovës, Pml-Kzz 147/2017, Aktgjykim, 20 korrik 2017, f. 13. Shih gjithashtu, ECtHR, *van de Hurk v. The Netherlands*, No. 16034/90, Judgment, 19 April 1994, para. 61.